



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

BOTIM I VEÇANTË 2011/01

# Monitorimi i programit informativ të Radiotelevizionit të Kosovës

Prishtinë, janar 2011

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

Ky publikim është pjesë e projektit të përkrahur nga Press Now dhe Ambasada Norvegjeze në Prishtinë.

Përgatiti: Krenar Gashi

Kontribuan me punën e tyre të palodhshme: Jeta Abazi, Burim Ejupi, Adem Gashi e Shkamb Qavdarbasha.

Copyright © 2011 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtërisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rexhep Mala, 5A, Kati II

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefon dhe Fax: +381 38 227 778

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## **PËRMBAJTJA**

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>4</b>
<b>2. Metodologjia.....</b>	<b>5</b>
<b>3. Analizë e rregullativës së standardeve profesionale .....</b>	<b>6</b>
<b>4. Lajmet qendrore .....</b>	<b>7</b>
4.1. Natyra e raporteve .....	9
4.2. Balancimi i informatave.....	10
4.2.1. Storjet e pabalancuara .....	12
4.2.2. Storjet e balancuara .....	13
4.2.3. Storjet “neutrale”.....	14
4.3. Burimet e informacionit .....	15
4.4. Lajmet e para.....	15
4.5. Fenomeni i ndarjes së storjeve .....	17
<b>5. Emisionet informative .....</b>	<b>18</b>
5.1. Emisioni “10 Minuta” .....	18
5.2. “Jeta në Kosovë” .....	20
5.3. “Protagonisti” .....	21
5.4. Emisionet “Speciale” .....	21
<b>6. Sqarime .....</b>	<b>22</b>

## 1. HYRJE

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është institucion publik i rëndësisë së veçantë. Me një kanal televiziv dhe dy radio stacione, RTK është i vetmi transmetues publik në Kosovë. I financuar nga taksapaguesit, përgjegjësia e RTK qëndron ndaj publikut dhe informimit adekuat të tij. Pavarësia e RTK-së garantohet me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës.<sup>1</sup> Ky medium transmeton program në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe rome, ndërkohë që vazhdon të jetë mediumi elektronik më i shikuar dhe më i besuar në Kosovë.

Misioni i RTK-së si transmetues publik është i një rëndësie qenësore për demokracinë në Kosovë. Garantimi i pavarësisë financiare, menaxheriale dhe editoriale të RTK-së, kësajsoj, mbetet një obligim i gjithë shoqërisë Kosovare. Megjithatë, gjatë konsolidimit të institucioneve të Republikës së Kosovës, RTK-ja është lënë anash në agjendën e legjislativit për një kohë të gjatë, gjë që e ka dëmtuar rëndë këtë institucion. Vonesat e bëra në Kuvendin e Kosovës në emërimin e bordit të drejtorëve të RTK-së e kanë çuar RTK-në drejt një devalvimi në skenën mediale të Kosovës.<sup>2</sup> Ndërhyrjet e mundshme politike në këtë proces kanë krijuar një dyshim në opinionin publik sa i përket pavarësisë së këtij mediumi.

Që nga viti 2008, Qeveria e Kosovës ka bërë disa ndërhyrje të njëpasnjëshme në RTK, duke e rrezikuar rrënjësisht pavarësinë e këtij mediumi. Së pari, komisioni parlamentar për emërim të anëtarëve të bordit të RTK-së ka qenë i kryesuar nga zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi. Me këtë kryesim, qeveria ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në emërimin e anëtarëve të bordit, organit më të lartë drejtues të këtij institucioni. Qeveria nuk është ndikuar nga presioni që kanë bërë shoqëria civile dhe prania ndërkombëtare në Kosovë. Kjo ndërhyrje e ekzekutivit në RTK është kritikuar edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2009.

Ndërhyrja e dytë në RTK është bërë me ndërprerjen e kontratës për mbledhjen e parapagimit për transmetuesin publik, kontratë kjo mes RTK-së dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Ani pse KEK-u është kompani publike dhe jo organ qeveritar, bordi i kësaj kompanie emërohet drejtpërdrejt nga qeveria dhe ndikimi i ekzekutivit në këtë bord është shumë evident. Pas shkëputjes së kontratës nga ana e KEK-ut dhe pamundësisë që parapagimi prej 3.5 euro për shtëpi të mbledhet në ndonjë formë tjetër, RTK-ja është detyruar të kërkojë mjete financiare nga Kuvendi i Kosovës..<sup>3</sup> Fakti që buxheti aktual i RTK-së vjen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit, si dhe fakti që nuk ka ndonjë zgjidhje të qëndrueshme financiare për të, vë një pikëpyetje të madhe nëse ky medium do të mund ta ruajë statusin e transmetuesit publik. Shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare kanë shprehur frikën e tyre se RTK-ja do të mund të shndërrohej në një televizion shtetëror. Këtu vlen të përmendet Unioni Evropian i Transmetimeve (EBU) dhe

---

<sup>1</sup> Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, neni 1 dhe 6,

<sup>2</sup> Gjatë tryezës së rrumbullakët, Esat Brajšori, nga Komiteti për Administratë Publike dhe Media pranë Kuvendit të Kosovës ka bërë me dije se një pjesë e vonesave kanë qenë si shkak i aplikimit të personave të anëtarësuar në parti. Sipas tij një (1) listë është refuzuar për këto shkaqe.

<sup>3</sup> Drejtori aktual i RTK-së e ka cilësuar këtë vendim për ndërprerje të kontratës me KEK si politik, të shtyrë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Tryezë e rrumbullakët e KIPRED mbi raportit të monitorimit të RTK-së, tetor 2010.

letra që shefi i këtij unioni i ka dërguar kryeministrit Hashim Thaçi, ku ka shprehur brengën e tij se RTK-ja po shndërrohet në një armë të partisë kryesore në pushtet.<sup>4</sup>

Ndikimet e shumta politike dhe presioni qeveritar kanë shtyrë ish drejtorin e përgjithshëm të RTK-së, Agim Zatriqi, të jap dorëheqje nga ky post. Në letrën e dorëheqjes, Zatriqi pati shkruar se atij i është pamundësuar që të ushtrojë me përgjegjësi edhe më tutje detyrën e kreut të këtij institucioni.<sup>5</sup> Tre muaj pas dorëheqjes së Zatriqit, bordi i ri i RTK-së emëroi Sylejman Shaqirin për drejtor të përgjithshëm. Procesi i rekrutimit të menaxhmentit të lartë të RTK-së është ende në vazhdim, ku pas emërimit të drejtorit të programit televiziv, mbetet për t'u përzgjedhur edhe kryeredaktori, pozitë kjo qenësore në këtë medium.

Kritikat për përzgjedhjen e bordit dhe menaxhmentit të RTK-së kanë vazhduar në sferën publike kosovare, ndërsa është vënë re një rënie e kualitetit programor në këtë medium. Përkundër faktit që RTK është cilësuar të jetë shndërruar në një zëdhënës të pushtetit, asnjë hulumtim empirik nuk është ndërmarrë në këtë fushë.

Duke ditur rëndësinë e RTK-së si medium publik, rëndësinë jetike të pavarësisë editoriale të këtij mediumi dhe ndikimin që RTK-ja ka në krijimin e opinionit publik dhe një debati të informuar demokratik në Kosovë, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) ka vendosur që të bëjë një monitorim të programit informativ të RTK-së. Qëllimi i këtij monitorimi është që të identifikohen pikat më të dobëta në programin informativ të televizionit dhe të draftohen rekomandime konkrete se si duhet përmirësuar këto dobësi.

Ky raport i pavarur është vetëm një pilot-projekt, nismë kjo vetanake e institutit KIPRED. Me bindjen se një monitorim transparent i kualitetit programor të RTK-së do të shpinte tek një përmirësim i vazhdueshëm i këtij programi, KIPRED mëton që në të ardhmen të vazhdojë monitorimin e programit të RTK-së, duke zgjeruar fokusin dhe metodat e monitorimit.

## 2. METODOLOGJIA

Instituti KIPRED ka përdorur një metodologji të përzier gjatë hulumtimit për përpilimin e këtij raporti, duke përfshirë format kuantitative dhe kualitative të monitorimit të drejtpërdrejtë të programit informativ në RTK. Kësisoj, KIPRED ka monitoruar të gjithë programin informativ të transmetuar mes orës 19:30 dhe 23:00. Përzgjedhja e orarit është bërë në bazë të rezultateve të anketave të mëhershme të cilat tregojnë këtë orar si kohën kur shikueshmëria e programit televiziv është më e larta gjatë ditës. Fokusi kryesor i këtij monitorimi kanë qenë edicionet qendrore të lajmeve që në RTK transmetohen prej orës 19:30.<sup>6</sup> Emisionet tjera që janë monitoruar janë *10 Minuta*, *Protagonisti*, *Jeta në Kosovë*, si dhe edicionet speciale apo intervistat e transmetuara gjatë kësaj kohe. Gjithashtu janë

---

<sup>4</sup> EBU: Kosovo's RTK is "Media Arm" of PM (EBU: RTK-ja është armë mediale e kryeministrit), Balkan Insight, 26 tetor 2009, qasur me 16 shtator 2010 në <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/23192/>

<sup>5</sup> "Sylejman Shaqiri Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së", Portali Koha.Net dhe Gazeta Koha Ditore, 26 janar 2010, qasur në <http://www.koha.net/index.php?cid=1,7,9770> me 16 shtator 2010.

<sup>6</sup> Gjatë tryezës së rrumbullakët të organizuar për diskutimin e këtij punimi, përfaqësues të RTK-së kanë thënë se është dashur të të monitorohen edhe edicionet e tjera ngase ato e plotësojnë edicionin qendror të lajmeve. Sidoqoftë, për qëllimin e këtij studimi KIPRED mendon që lajmet qendrore kanë qënë më se të mjaftueshme.

monitoruar edhe emisionet *Subvencion, Aktualiteti, dhe Evropa më afër* mirëpo të gjeturat rreth këtyre emisioneve nuk janë paraqitur në këtë raport monitorues.

Me qëllim të zvogëlimit të mundësive për gabime teknike, KIPRED ka regjistruar gjithë programin e transmetuar në format DVD, të cilat më pas janë shikuar me kujdes nga monitoruesit tanë. Raste të veçanta të trajtuara në këtë raport janë analizuar edhe pas përfundimit të procesit të monitorimit. Të dhënat e monitorimit janë regjistruar në një bazë të përbashkët shënimesh, nga e cila më pas janë nxjerrë statistikat si njësi bazë e këtij raporti.

Monitorimi i programit informativ ka filluar me 15 prill 2010 dhe ka përfunduar me 15 korrik të po të njëjtit vit. Gjatë kësaj periudhe tremujore, KIPRED është fokusuar në monitorimin e lajmeve qendrore, të cilat janë monitoruar storje për storje, por edhe si tërësi. Gjatë procesit të monitorimit, KIPRED ka krijuar një bazë të të dhënave, ku janë përfshirë, mes tjerash, edhe këto elemente: renditja e lajmeve, kategoria e lajmeve, pamjet që janë përdorur, kush është prezantuar, objektiviteti dhe balancimi i lajmit, rëndësia e lajmit, konotacionet politike si dhe numri i burimeve të cituara.

Përgjatë monitorimit, KIPRED ka marrë parasysh pikë së pari “Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës”<sup>7</sup> dokument ky i sajuar nga RTK-ja, i cili është i bazuar në ato që njihen si standarde ndërkombëtare të gazetarisë.

Të gjitha kategorizimet dhe vlerësimet e storjeve të lajmeve dhe elementeve tjera programore gjatë këtij monitorimi janë bërë kryekëput në bazë të këtij dokumenti gjithëpërfshirës. Storjet e transmetuara si inserte gjatë emisioneve të ndryshme informative janë trajtuar njësoj sikurse edhe storjet e lajmeve. Kategorizimi sa i përket balancit dhe paanshmërisë së lajmit është bërë gjatë monitorimit dhe është konfirmuar edhe një herë gjatë përpilimit të këtij raporti. Margjina e gabimeve të të dhënave në këtë raport është në suaza të margjinës normative për raporte të tilla monitoruese, prej më pak se 5%. Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën eksperimentale të këtij projekti, nuk përjashtohen gabimet e vogla teknike, të cilat nuk do të mund të ndikojnë në mënyrë madhore në thelbin e këtij raporti hulumtues.

KIPRED po ashtu ka konsultuar të gjitha publikimet e mëhershme të cilat kanë pasur në fokus RTK-në apo çështjet tjera etike e profesionale që trajtohen në këtë raport, por ato nuk janë marrë parasysh kur është përpiluar pjesa e raportit që del nga monitorimi i programit.

### **3. ANALIZË E RREGULLATIVËS SË STANDARDEVE PROFESIONALE**

Si çdo medium, edhe RTK-ja e ka kodin e vet të etikës dhe normën e standardeve profesionale. Këto dy elemente janë përmbledhur në një dokument të titulluar “Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës” dokument i cili është publik dhe mund të shkarkohet nga uebfaqja zyrtare e RTK-së. Ky dokument përbëhet nga 22 kapitla që rregullojnë çështje

<sup>7</sup> “Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës”, RTK, Janar 2005, shkarkuar nga uebfaqja zyrtare e RTK-së në adresën [http://rtklive.com/rtk/standardetprofesionale\\_sq.pdf](http://rtklive.com/rtk/standardetprofesionale_sq.pdf) me 2 shtator 2010.

të ndryshme, duke filluar nga standardet profesionale, mënyrën e raportimit, çështjet etike, mbulimin e çështjeve politike, raportet e RTK-së me organizmat shtetëror, raportimin e fushatës elektorale e deri të kodet e veshjes apo konfliktin e interesit.

Nga analiza që i është bërë këtij dokumenti, KIPRED ka vërejtur një sërë mangësish dhe lëshimesh. Pikë së pari, dokumenti në fjalë është përpiluar në vitin 2005 dhe nga atëherë nuk është përmirësuar asnjëherë. Përkundër kësaj, ky kod rregullativ shihet të jetë përgatitur në mënyrë shumë të ngutshme. Përveç shumë gabimeve teknike e gjuhësore, kjo rregullore trajton çështjet etike e profesionale në mënyrë të përgjithësuar, duke lënë shumë hapësirë për interpretime. Për dallim prej shtëpive ndërkombëtare mediale, si BBC apo Associated Press, rregullorja e RTK-së nuk u tregon gazetarëve se si duhet balancuar raporti, si duhet trajtuar burimet dhe çka është një informacion i bazuar në burime të mjaftueshme.

KIPRED ka krahasuar shkarazi rregullativën e RTK-së me atë të transmetuesit publik të Britanisë së Madhe (BBC). Pjesa e kodit etik të punës të RTK që merret me çështjen e paanshmërisë dhe bilancit gjatë raportimit apo lajmeve është e përmbledhur në një paragraf të vetëm.<sup>8</sup> Sipas standardeve ndërkombëtare të gazetarisë, kjo është çështja më kyçe për secilin medium, sidomos për media publike që financohen nga paratë e taksapaguesve. BBC, për shembull, i kushton një rëndësi shumë më të madhe kësaj çështjeje, duke e sqaruar në detaje se si duhet të sillen dhe çfarë duhet bërë, përkundër faktit që gazetarët e këtij mediumi, të cilët duhet ta konsultojnë këtë rregullore, kanë njohuritë e duhura si dhe përvojën e duhur.

RTK, në ndërkohë, shkruan vetëm për natyrën subjektive të arritjes së imparcialitetit dhe balancimit nëpërmjet intervistimit të të gjitha palëve të përfshira në një çështje. Këtë e bën në një paragraf të shkurtër, duke e përsëritur në disa raste por pa e ndryshuar thelbin. Por sasia e kohës që i jepet këtyre palëve, sa larg duhet të shkojë gazetari për të kërkuar personat që duhet të shprehin pozitën e tyre dhe koha që ky transmetues duhet të harxhojë mbi një palë të caktuar mbeten të parregulluara dhe të panormatizuara.

Për më tepër, mënyra se si balancohet informacioni është akoma më i rëndësishëm kur një transmetues publik e raporton mbi vetveten. Për krahasim, BBC e ka një seksion të veçantë për mënyrën se si gazetarët e BBC duhet të raportojnë për BBC. RTK-së i mungon një aneks i tillë në kodin e tyre të etikës. Edhe pjesët tjera të kodit, që rregullojnë çështjen e mbulimit të aktiviteteve të partive politike dhe të protokollit të shtetit, janë të rregulluara në mënyrë shumë të përgjithshme, duke lënë hapësirë të madhe për interpretim nga gazetarët apo redaktorët e rastit.

#### **4. LAJMET QENDRORE**

Edicioni qendror i lajmeve në RTK, që transmetohet prej orës 19:30, është edicioni më i shikuar informativ në Kosovë me një shikueshmëri standarde prej më shumë se 500,000 telespektatorësh.<sup>9</sup> Kjo e bën këtë edicion të lajmeve emisionin më të rëndësishëm dhe më me ndikim në Kosovë në kategorinë e programeve informative.


---

<sup>8</sup> Gjatë tryezës së diskutimit, KIPRED-it i është kërkuar që të bëjë të qartë atë se çfarë përbën një rregullativë të përshtatshme. KIPRED gjykon që kjo është një çështje që do të ishte shumë e qartë në rast të konsultimit të kodit të dy agjencive të lartpërmendura.

<sup>9</sup> Analizë e programit të RTK-së dhe mediave tjera, Index Kosova, Shtator 2010

Ajo që është vërejtur qartë gjatë raportimit është një mungesë e tërësishme e sensitives në raportimet e RTK-së. Storjet kryesisht bazohen në ngjarjet e ndryshme ditore kurse redaksia shumë rrallë krijon agjendë të tyre të lajmeve. Me fjalë tjera, ajo që shohim gjatë edicionit të lajmeve në RTK, nuk është diktuar nga prioritetet e publikut por kryesisht nga agjendat e institucioneve shtetërore e partive politike, e në raste tjera edhe të shoqërisë civile dhe institucioneve ndërkombëtare. RTK-ja, duke mos përgatitur një agjendë prioritare të raportimeve dhe duke mos përkrahur dhe avancuar gazetarinë hulumtuese, i ngjason më shumë një zëdhënës të qeverisë, opozitës e deri diku edhe të shoqërisë civile, i cili veçse përçon te publiku atë që këto tri dikastere e thonë.

Gjatë periudhës së monitorimit<sup>10</sup> KIPRED ka vështruar gjithsej 1,449 storje informative të transmetuara në edicionin qendror lajmeve. Prej tyre, 1,157 kanë qenë lajme kombëtare, 76 lajme nga rajoni dhe 204 lajme ndërkombëtare. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, janë transmetuar edhe 12 storje me tema sportive, meqë RTK-ja shumicën e lajmeve sportive i transmeton në një edicion të veçantë, pas edicionit qendror të lajmeve.



**Figura 1 - Llojet e storjeve të lajmeve**

Rregullorja e RTK-së parasheh se duhet siguruar ekuilibri i duhur midis lajmeve vendore, rajonale e ndërkombëtare.<sup>11</sup> Ani pse kjo rregullore nuk sqaron se çfarë duhet të jetë proporcioni i këtij ekuilibrimi, nga monitorimi shihet se përqindja e lajmeve nga rajoni është shumë e vogël, madje tri herë më e vogël sesa lajmet ndërkombëtare. Po ashtu, niveli i kualitetit të lajmeve rajonale dhe ndërkombëtare është shumë më i dobët sesa i lajmeve vendore. Gabimet faktike që ndodhin në lajmet rajonale e ndërkombëtare janë të shpeshta duke lënë të kuptohet se redaksia e RTK-së nuk u jep prioritetin dhe rëndësinë e duhur këtyre lajmeve. Nëpër këto kronika, është vërejtur se shumë shpesh nuk sqarohen çështjet për të cilat flitet, nuk ka informata shtesë apo informata krahasuese të cilat do ta bënin teleshikuesin t'i kuptonte ato. Si pasojë, vëmendja e shikuesve gjatë transmetimeve të këtyre lajmeve medoemos zvogëlohet.

<sup>10</sup> Prej 15 prill 2010 deri më 15 korrik 2010

<sup>11</sup> "Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës", Neni 2.1, RTK, Janar 2005



Gjatë monitorimit, KIPRED ka shënuar komente eventuale për thyerjen e kodit etik të RTK-së, për secilën storje veç e veç. Këtu, kemi veçuar vetëm storjet ku në mënyrë eksplicite shkelen rregullat etike apo standardet profesionale, duke lënë anash kualitetin e raportimit dhe natyrën e tij. Nga monitorimi del se në 21% të rasteve, gazetarët e RTK-së kanë shkëlur kodin e tyre të etikës dhe normën e standardeve.

#### 4.1. Natyra e raporteve

Gjatë monitorimit, KIPRED ka analizuar me kujdes vetëm mënyrën e raportimit dhe natyrën e lajmeve vendore. Të gjitha 1,157 lajmet vendore, i kemi kategorizuar në pesë (5) kategori, varësisht prej natyrës së lajmit.

**Storje ekskluzive** janë vlerësuar ato storje për të cilat RTK-ja ka pasur ekskluzivitet në transmetim dhe storjet hulumtuese të vet RTK-së.<sup>12</sup>

**Storje raportuese** (në grafikone të cilësuar si ngjarje/raportim) janë vlerësuar storjet e thjeshta raportuese prej ngjarjeve të ndryshme ditore, ku redaksia vetëm ka përçuar faktet e prezentuara në këto ngjarje. Në këto storje nuk janë cituar burime shtesë dhe karakteri i tyre është karakter i drejtpërdrejtë përçues, pa verifikim të burimeve të dyta, qofshin ato kundërshtuese apo të paanshme. Këto storje, sipas standardeve ndërkombëtare të gazetarisë mund të cilësohen edhe si gazetari protokollare.

Megjithatë, në këtë raport, **storje protokollare** i kemi cilësuar vetëm ato storje që kanë raportuar për protokollin shtetëror, e që në vete nuk kanë përmbajtur kurrfarë vlere tjetër të informacionit, pos zbatimit të këtij protokolli. Me fjalë tjera, këtu bëjnë pjesë storjet që raportojnë për takime të presidentit, kryeminsitrit apo ministrave e zyrtarëve të ndryshëm, ku bazë për raportim është takimi dhe jo substanca apo ajo që është thënë në këto takime.


Si **storje të redaksisë** (në grafikone të cilësuar si storje) janë vlerësuar storjet që trajtojnë tema aktuale, e që nuk janë të bazuara ekskluzivisht në ndonjë ngjarje të veçantë ditore. Këtu hyjnë temat e iniciuara nga redaksia, apo temat që burojnë nga një ngjarje ditore po për të cilën redaksia ka përdorur edhe burime shtesë.

Si **intervista** janë cilësuar intervistat në studio, intervistat me kyçje të drejtpërdrejta në programin qendror informativ, apo storje eventuale që kanë qenë tërësisht të bazuara në një intervistë të vetme.

Në bazë të këtij klasifikimi, del se shumica absolute e storjeve të transmetuara në edicionin qendror të lajmeve janë storje përçuese, në kuotë prej 73%. Në këto storje gazetarët kanë raportuar vetëm për atë që ka ndodhur në një ngjarje, me një apo më shumë burime nga ajo ngjarje, por pa konsultuar burime shtesë.

---

<sup>12</sup> Në tryezë të rumbullakët janë ngritur dyshime rreth kategorizimit të lajmeve the interpretimit. Sipas disa të pranishmëve kategoritë dhe interpretimi mund të jetë subjektiv. KIPRED përsërit që kategoritë janë ndarë në bazë të parimeve të gazetarisë ndërsa për sa i përket interpretimit është bërë një seleksionim në të verbër i mostrave të lajmeve dhe është interpretuar nga disa monitorues për të siguruar konsistencën dhe paanshmërinë e interpretimit.



**Figura 2 - Lajmet vendore sipas natyrës së raportimit**

Lajmet të cilat KIPRED, përmes një kriteri shumë të butë, i ka cilësuar si protokoll, përbëjnë 16% të numrit total të storjeve të transmetuara. Në këtë kategori hyjnë edhe vendimet e marra në mbledhje të qeverisë të cilat në vend se të trajtojnë çështjen mbi të cilën është vendosur, vetëm përçojnë vendimin.


Storje të krijuara nga agjenda e vet redaksisë, janë vetëm 7% të storjeve të emetuara, 4% e storjeve janë të bazuara në intervista, ndërsa në këtë periudhë kohore RTK ka transmetuar vetëm 4 storje ekskluzive, apo 0.35% të storjeve të emetuara.

#### **4.2. Balancimi i informatave**

Gjatë monitorimit, përgjithësisht është vërejtur se ekziston një balancim joformal i storjeve të lajmeve në RTK, i cili nuk është i bazuar në natyrën e informacionit por më shumë në natyrën e përkatësisë politike të burimeve të informacionit. Kësisoj, në RTK, aktivitetet e qeverisë raportohen kryekëput përmes burimeve të qeverisë. Për të balancuar politikisht këto raporte, u jepet hapësirë edhe partive opozitare dhe shoqërisë civile të kritikojnë qeverinë, në raporte të lajmeve që zakonisht janë të njëanshme. Në vend se të bëhet raportimi i bazuar në çështje të ndryshme, me prioritet për publikun, RTK-ja raporton veç e veç, njëherë për aktivitetet e qeverisë e më pas për ata që janë kritikë për punën e saj, duke e humbur kështu sensin dhe rëndësinë e lajmit të bazuar në çështje me interes.


Gjatë tre muajve të monitorimit, storje të balancuara janë kategorizuar ato storje ku është trajtuar një çështje dhe ku gazetari dhe redaksia kanë marrë mendimin e të gjitha palëve të përfshira. Storje të pabalancuara janë kategorizuar storjet ku është prezantuar vetëm njëra palë, me akuza konkrete dhe të ashpra për palën tjetër, e ku gazetari nuk ka konsultuar palën e akuzuar dhe as që është munduar që ta bëjë këtë. Megjithatë, shumica e storjeve janë klasifikuar si storje neutrale apo storje që nuk kanë nevojë për balancim. Kjo për shkak të natyrës së lajmeve në RTK, shumica absolute e të cilave, siç u dokumentua më herët, vetëm përçojnë një ngjarje ose një aktivitet, pa analizuar çështjet që dalin nga ajo

ngjarje apo ai aktivitet. Në grafikon shihet se përqindja e storjeve neutrale ka qenë 69%, storje të balancuara 25% ndërsa të pabalancuara 6%.



**Figura 3 - Balancimi i storjeve**

Nga storjet që kanë pasur nevojë të balancohen, pra ku një palë është prezantuar të ketë kritikuar palën tjetër, në 82% të rasteve gazetarët dhe redaktorët e RTK-së e kanë kryer detyrën e tyre si duhet, kurse në 18% të rasteve nuk e kanë bërë këtë. Nëse marrim parasysh karakterin e këtyre storjeve, që zakonisht është politik, atëherë përqindja e storjeve të njëanshme, të pabalancuara, është tejet e madhe. Politika redaktuese e RTK-së lejon që 18% të storjeve të tyre të shkelin kodin e etikës dhe standardet profesionale të këtij mediumi.<sup>13</sup> Shkeljet e këtij niveli, në rast se ndodhin, do duhej të përfundonin me sanksionimin e gazetarëve apo redaktorëve.



**Figura 4 - Balancimi i storjeve të cilat kanë pas nevojë për balancim**


<sup>13</sup> “Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës”, Neni 2.3, RTK, Janar 2005,

#### 4.2.1. Storjet e pabalancuara

Natyra e storjeve të pabalancuara është e ndryshme. Megjithatë ajo që është shqetësuese është fakti se zakonisht në këtë kategori të storjeve bëhen kritika apo deklarata akuzuese të drejtpërdrejta ndaj personave fizik apo juridik. Gazetarët dhe redaktorët janë të obliguar që medoemos të marrin përgjigjen e personave të akuzuar apo të kritikuar, apo të paktën ta bindin publikun që kanë provuar të bëjnë një gjë të tillë. Shumica e storjeve të RTK-së që janë të pabalancuara nisin e përfundojnë duke cituar vetëm njërën palë, pra palën akuzuese.

Storjet e tilla bëhen më problematike në kritikën politike. Shumica e kritikave që ngrihen nga shoqëria civile dhe opozita për punën e dikastereve të ndryshme të qeverisë, nuk balancohen me opinionet e përfaqësuesve të ekzekutivit. Për më shumë, RTK-ja në shumicën absolute të rasteve kur kanë transmetuar kritika të tilla, nuk kanë konsultuar ndonjë burim të pavarur për t'i vërtetuar ato kritika. Kësisoj, RTK ka kontribuar në krijimin e një përshtypje të gabuar se opozita dhe shoqëria civile vazhdimisht kritikojnë për gjithçka.

Për kah natyra se kush prezantohet në lajmet e pabalancuara, prijnë raportet për opozitën me 34%, shoqëria civile 19%, mendimet e qytetarëve me 12%, si dhe qeveria, pushteti lokal dhe EULEX-i me nga 5%.



**Figura 5 - Institucionet të cilat prezantohen në lajmet e pabalancuara**

*\*Zyra e KM, Agjenci të Pavarura, Ambasada, Biznes, Deputet, Kompani Publike, Agjenci Qeveritare apo Ndërkombëtare*

Kësisoj, RTK ka transmetuar kritikën e vazhdueshme të liderit të AAK-së, për qeverinë e Kosovës, të cilat zakonisht nuk janë ballafaquar me përfaqësuesit e dikasterit përkatës.<sup>14</sup> Pas liderit të AAK-së, në të njëjtën cilësi vijnë pjesëtarët e shoqërisë civile. Lëvizja Fol është cituar disa herë të ketë kritikuar qeverinë në raporte të cilat kanë përfunduar vetëm

<sup>14</sup> Ky fenomen është vërejtur më së miri në edicionet e lajmeve të datës 18 prill 2010, 22 prill 2010, 14 maj 2010, etj.

me mendimet e kësaj lëvizjeje.<sup>15</sup> Në këtë mënyrë, duke raportuar në formë të pabalancuar, RTK-ja e ka ngulatur qëllimin e opozitës dhe shoqërisë civile, duke i lënë kritikën e tyre të jehojnë në hapësirë, pa u mundur që t'i vërtetojë ato dhe pa i ballafaquar ato me personat përgjegjës nga sektori qeveritar. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në dëmtimin e imazhit të opozitës, por sidomos të shoqërisë civile, të cilët mund të perceptohen si kritikë kronike e të pa bazë, ani pse vërejtjet e tyre shumë shpesh kanë mundur të vërtetohen fare lehtë nga burime tjera të pavarura apo nga vet reporterët e RTK-së përmes raportimit direkt.

Lajmet e tilla, të njëanshme, janë posaçërisht të rrezikshme për shoqërinë kur në to trajtohen tema që kanë të bëjnë me përndjekje kriminale. RTK-ja është mundur që në parim ta respektoj faktin që të akuzuarit janë të pafajshëm deri sa nuk të vërtetohet e kundërta nga një gjykatë, megjithatë jo gjithmonë kanë konsultuar të gjitha palët e përfshira në konteste të tilla. Një shembull i tillë ka qenë procesi gjyqësor kundër liderit të Lëvizjes Vetëvendosje, ku gazetarët shpesh kanë injoruar faktin se duhet intervistuar të gjitha palët e përfshira.<sup>16</sup> E njëjta gjë ka ndodhur edhe me rastin e arrestimit të një ish-komandanti të UÇK-së.<sup>17</sup> Në raste të tilla, redaksia e RTK-së duhet dërguar gazetarët me përvojë gjegjëse që të raportojnë për to, sepse një raportim i njëanshëm mund të ketë ndikim jo vetëm në krijim e një opinioni të gabuar publik, por madje edhe në vet sistemin e drejtësisë dhe vendimet e gjykatës në Kosovë.

#### 4.2.2. Storjet e balancuara

Storjet e balancuara mirë kanë qenë të pakta në RTK gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Megjithatë, ka një laramani të mirë të prezantimit në këto storje. Më së shumti në storjet e balancuara janë prezantuar qytetarët, në 26% të tyre, në 14% qeveria, shoqëria civile në 8%, zyra e kryeministrit në 7%, bizneset në 6%, e kështu më radhë.




Figura 6 - Institucionet të cilat prezantohen në lajmet e balancuara

<sup>15</sup> Raste më reprezentative të raportimeve të tilla janë shënuar në edicionet e lajmeve të datës 1 maj 2010, 11 maj 2010, etj.

<sup>16</sup> Përgjatë raportimeve gjatë edicioneve të lajmeve në muajin prill 2010.


<sup>17</sup> Edicionet e lajmeve të datës 6 maj 2010, 8 maj 2010, etj.

\*Agjenci Qeveritare, të Pavarura, Ambasada, Arsimtar, ATK, BQK, Doktor, FSK, Gjykata, KFOR, Kompani Publike, KQZ, Kuvendi i Kosovës, Ndërkombëtar, Opozita, Policia, Presidenca, Serbia, UP

### 4.2.3. Storjet “neutrale”

Në anën tjetër, aktivitetet e qeverisë zakonisht janë kategorizuar si storje neutrale, meqë në to veçse i është përcjellë publikut një aktivitet i caktuar. Edhe pse zyrtarët qeveritarë nuk ngrisin akuza apo kritika ndaj askujt, është obligim i redaksisë së RTK-së që deklaratat e tyre të vërtetohen nga burime të pavarura, gjë e cila në shumicën absolute të rasteve nuk ndodhë.

Në storjet e tilla, që në këtë raport vlerësohen si neutrale, e që në fakt janë vetëm storje promovuese, më së shumti prezantohet qeveria dhe organet qeveritare -- në kuotë prej 24% -- të ndjekura nga ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare me 11%, shoqëria civile me 8%, opozita me 6%, presidenca me 5%, pushteti lokal me 5% si dhe komuniteti i biznesit me 2%.



**Figura 7 - Institucionet të cilat prezantohen në lajmet neutrale**

\*Qeveria, Zyra e KM, Agjenci Qeveritare, Kompanitë Publike

\*\*Agjenci të Pavarura, Arsim, Bashkësia Islame, Bektashi, Deputet, Dogana, EULEX, FSK, Gjykata, Gjykata Kushtetuese, ICO, Intervistë, KFOR, KQZ, Kulturë, Kuvendi i Kosovës, Lajme nga Diaspora, Ombudspersoni, Parti Politike, Policia, Qytetar, RTK, Serbia, Shërbyesit civil, Shkencë, Shqipëria, Sllovenia, UP

Duke e parë se përqindja e storjeve ku prezantohen institucionet shtetërore të Kosovës arrijnë në 24%, mund të thuhet se përqindja më e madhe e storjeve që ne i kemi quajtur neutrale, e që janë storje që në mënyrë të thjeshtë promovojnë aktivitete të ndryshme, u takon promovimit të institucioneve shtetërore.

### 4.3. Burimet e informacionit

Gjatë monitorimit të lajmeve, KIPRED ka bërë edhe matjen e burimeve të informacioneve të përdorura në lajme. Burime janë konsideruar të gjithë të intervistuarit brenda një storjeje apo të gjithë personat fizikë e juridikë si dhe dokumentet të cilëve reporteri i është referuar në mënyrë eksplicite gjatë raportimit.

Në përgjithësi, nga të gjitha storjet e monitoruara, mesatarja e burimeve të përdorura nga RTK për një storje ka qenë 2.15, apo vetëm pak më shumë sesa ajo që konsiderohet standard ndërkombëtar i të referuarit së paku 2 burime për lajm.

Kjo mesatare është më e vogël, meqë burime janë konsideruar edhe qytetarët të cilët janë intervistuar në stilin vox populi, e të cilat nuk i kemi përjashtuar nga kjo llogaritje.

Sipas monitorimit, del se 33% të storjeve të transmetuara në edicionet e lajmeve të RTK-së kanë qenë të bazuara vetëm në një burim. 35% të storjeve kanë cituar 2 burime dhe 21% të tyre nga 3 burime.




Figura 8 - Numri i burimeve të përdorura në storje


Përqindja e storjeve që kanë shumë burime e që shihet në grafikon është po ashtu si rezultat i intervistave vox populi ku citohen shumë qytetarë të rëndomtë.

KIPRED ka shikuar edhe numrin e burimeve nëpër lajmet ku prezantohet sektori qeveritar. Nga monitorimi del se 30% të lajmeve ku prezantohet qeveria bazohen në një burim të vetëm. Lajme me dy burime që përshijnë qeverinë janë 41%, por këto dy burime shumë shpesh janë burim se nga i njëjti sektor, pra nga sektori qeveritar. Në 20% të lajmeve RTK ka përdorur 3 burime kurse vetëm në 5% të rasteve lajmi është bazuar në 4 burime.

### 4.4. Lajmet e para

Renditja e lajmeve është qenësore për çdo edicion lajmesh në çdo medium. Në televizione kjo renditje duhet të bëhet në bazë të rëndësisë së lajmit. Tek televizionet publike, përcaktimi i rëndësisë së lajmit është edhe më i lehtë, meqë ky vendim duhet të merret kryekëput duke konsideruar se çka është e rëndësishme për publikun dhe shoqërinë.

Në RTK, aktivitetet e qeverisë dhe deklaratat e zyrtarëve qeveritarë janë gjithmonë në rend të parë.<sup>18</sup> Kësisoj, nga gjithë edicionet e lajmeve që kemi monitoruar, aktivitetet e qeverisë dominojnë sa i përket prezantimit në lajmin e parë të mbrëmjes, në një kuotë prej 20%. Opozita, në anën tjetër, asnjëherë nuk është prezantuar në lajmin e parë. Deklaratat dhe aktivitetet e shoqërisë civile kanë zënë 6% të lajmeve të para, kurse ato të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare 12%.




**Figura 9 - Institucionet të cilat janë prezantuar në lajmin e parë**

Për të analizuar më mirë fenomenin e përcaktimit të renditjes së lajmeve, KIPRED ka vështruar edhe kategorizimin në bazë të tri lajmeve të para. Në këtë analizë të të dhënave shihet se 29% të tri lajmeve të para i përbën qeveria, 4% opozita, 5% shoqëria civile dhe 10% faktorët ndërkombëtarë.

<sup>18</sup> Drejtorit i RTK-së, Sylejman Shaqiri ka thënë në tryezën e diskutimit se shkak i këtyre gjetjeve rreth tre lajmeve të para është fakti se lajmi i dytë dhe i tretë zakonisht plotësojnë lajmin e parë në edicionet informative të RTK. Sidoqoftë, është opinioni i KIPRED që tre storjet e para duhet të jenë të ndryshme, me një përfaqësim më të denjë të çështjeve si të tilla dhe me më pak storje protokollare.





**Figura 10 - Prezantimi i institucioneve në 3 lajmet e para**

Monitoruesit tanë kanë vërejtur se prioriteti që i është dhënë veprimtarive qeveritare gjatë raportimit, jo gjithmonë ka qenë me vend. Kësisoj, lajmet për takimet e protokollare të zëvendëskryeministrit të vendit janë dhënë para lajmeve për procesin gjyqësor kundër Albin Kurtit, proces ky që ka zgjuar një vëmendje dhe kureshtje shumë të madhe të publikut.

Ndërsa rasti më eklatant në këtë aspekt është vizita e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës në Bullgari, vizitë kjo për të cilën është raportuar tri ditë rresht në lajmet e mbrëmjes. Me 19 prill 2010, RTK ka paralajmëruar vizitën e Krasniqit në Bullgari, të pasnesërmen ka raportuar për takimet e tij me zyrtarë të shtetit bullgar dhe një ditë pas ka raportuar se takimet e Krasniqit vazhdojnë.<sup>19</sup> Këto storje si të tilla e humbin vlerën e informacionit dhe zënë pa nevojë minutazhin e lajmeve qendrore.

#### **4.5. Fenomeni i ndarjes së storjeve**

Me qëllim të trajtimit sa më të mirë të ngjarjeve apo tematikave të rëndësishme për shoqërinë, RTK-ja shpesh bën mbulimin e tyre në më shumë se një storje gjatë edicionit të lajmeve. Kjo metodë është shumë efikase sidomos për mbulimin e temave komplekse. Megjithatë, gjatë monitorimit kemi vërejtur se gazetarët dhe redaktorët e RTK-së jo rrallë herë gabojnë në vlerësimet e tilla. Si rezultat ndodhë që të kemi ndarje të storjeve në dy apo tri sosh, pa ndonjë nevojë specifike.

Në këtë frymë, gjatë muajit prill, RTK ka raportuar në vazhdimësi për dy aktivitete të qeverisë, e që janë trajtuar në më shumë storje. Shembujt më reprezentativ të këtij fenomeni janë raportimet për largimin e operatorëve ilegalë të telefonisë mobile, si dhe raportimet për ndërtimin e autostradës Merdare-Morinë.<sup>20</sup>

Lufta kundër korrupsionit po ashtu është raportuar në mënyrë maratonike, ani pse këto storje nuk kanë pasur ndonjë substancë të veçantë të informacionit. Kësisoj, në një

<sup>19</sup> Edicionet qendrore të datës 19, 21 dhe 22 prill.

<sup>20</sup> Edicioni qendror i lajmeve, 23 dhe 24 prill 2010.

edicion të vetëm të lajmeve, janë raportuar pesë storje të ndara, ku faktorë vendor e ndërkombëtar kanë theksuar se e përkrahin luftën kundër korrupsionit.<sup>21</sup>

Gjatë kësaj dite kanë dominuar lajme nga fusha e korrupsionit, të pesë titujt e lajmeve janë Lista e të dyshuarve për korrupsion, Hashim Thaci: Lufta kundër korrupsionit, Endi Sparks- Lufta kundër korrupsionit, Dogana - Në veri Ka rënie e kontrabandë, Lista e të dyshuarve për korrupsion.

## 5. EMISIONET INFORMATIVE

Gjatë këtyre tre muajve të hulumtimit, KIPRED ka bërë edhe monitorimin e emisioneve tjera me karakter informativ. Megjithatë, në fokus të monitorimit, për shkak të natyrës së emisioneve dhe rëndësisë së tyre, kanë qenë emisionet 10 Minuta, Jeta në Kosovë, dhe Protagonisti. Disa emisione tjera informative nuk janë transmetuar përgjatë gjithë kohës së monitorimit, andaj nuk i kemi analizuar hollësisht, ndërsa disa tjera i kemi monitoruar por nuk i kemi përfshirë në këtë raport.

### 5.1. Emisioni “10 Minuta”

Emisioni “10 Minuta” ka qenë emision informativ me karakter debati të shpejtë mes dy mysafirëve dhe një moderatori, që është transmetuar menjëherë pas edicionit qendror të lajmeve. Ky emision është monitoruar nga data 15 prill 2010, e deri më 10 qershor 2010, meqë pas kësaj date nuk është transmetuar më. Emisioni ka qenë i drejtpërdrejtë dhe ka pasur shikueshmëri të kënaqshme.

Ani pse në shumicën e emisioneve temat dhe mysafirët kanë qenë adekuat dhe kanë përfaqësuar dy palë apo mendime të ndryshme për temën, ka pasur shumë raste kur janë vërejtur lëshime në përzgjedhjen e mysafirëve.




Figura 11 - Të ftuarit në emisionin 10 Minuta

<sup>21</sup> Edicioni qendror i lajmeve i datës 15 prill 2010.

KIPRED ka vlerësuar se në 66% të rasteve mysafirët kanë qenë relevant dhe debati i balancuar. Në 25% të rasteve reprezentimi i mysafirëve ka qenë joadekuat, kurse në 9% të rasteve mysafirët kanë qenë jo relevantë por edhe debati ka qenë i pabalancuar.

Ajo që gjatë monitorimit është vërejtur si dukuri negative në këtë emision është prezenca joadekuat e mysafirëve. Për të diskutuar për funksionimin e drejtësisë në Kosovë, redaksia ka ftuar përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe një deputete të AKR-së. Përkundër faktit që është ligjvënëse, deputetja e ftuar nuk ishte personi më kompetent për tu ballafaquar me përfaqësuesin e KGJK-së, meqë ajo nuk ishte pjesë e ndonjë Komisioni Parlamentar përkatës.<sup>22</sup>

I njëjti fenomen është përsëritur kur është diskutuar çështja e liberalizimit të vizave, ku të ftuar ishin ministri i brendshëm dhe një deputet nga AAK, i cili po ashtu nuk është pjesë e ndonjë komisioni adekuat parlamentar për këtë çështje.<sup>23</sup>

Në Kuvendin e Kosovës ekzistojnë Komisione Parlamentare të cilat mbulojnë të gjitha fushat dhe në to ka përfaqësues të partive qeveritare e atyre opozitare të cilët kanë mundur të ftohen, nëse redaksia me të vërtetë do të insistonte në reprezentim nga legjislativi.

Ka pasur raste kur që të dy mysafirët kanë qenë joadekuat në këtë emision. Në një rast të tillë, kur është diskutuar për privatizimin e PTK-së, në studio janë ftuar kryetari i sindikatës së kësaj ndërmarrjeje dhe një analist nga një institut joqeveritar.<sup>24</sup>

Ndërsa rasti më eklatant dhe njëkohësisht rast komik ka qenë me të filluar kampionati botëror në futboll, ku për të diskutuar për këtë kampionat, RTK-ja ka ftuar në studio Ferid Zekollin, veteran i basketbollit dhe Aziz Salihun, veteran i boksit.<sup>25</sup>

Një fenomen tjetër ka të bëjë me mungesën e bilancit apo me zhvillimin e debatit të njëanshëm në këtë emision. Kjo ka ndodhur kur të dy debatuesit kanë qenë nga i njëjti profil apo nga e njëjta palë.

Kësisoj, kur është diskutuar për lirinë e medias, në studio kanë “debatuar” drejtori i Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK) dhe një gazetar i agjencisë KosovaPress.<sup>26</sup> Në debatin për korrupsionin në Kosovë në studio kanë qenë Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe shefi i Agjencisë Anti-Korrupsion.<sup>27</sup> Kurse për deklarimin e pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë kanë diskutuar sërish shefi i Agjencisë Anti-Korrupsion dhe drejtori i Lëvizjes Fol<sup>28</sup>.

---

<sup>22</sup> Emisioni “10 minuta” i datës 15 prill 2010.

<sup>23</sup> Emisioni “10 minuta” i datës 16 prill 2010


<sup>24</sup> Emisioni “10 minuta” i datës 24 prill 2010

<sup>25</sup> Emisioni “10 minuta” i datës 10 qershor 2010

<sup>26</sup> Emisioni “10 minuta” i datës 3 maj 2010

<sup>27</sup> Emisioni “10 minuta” i datës 19 prill 2010

<sup>28</sup> Emisioni “10 minuta” i datës 1 qershor 2010



**Figura 12 - Ballafaqimi i pjesëmarrësve**

## 5.2. “Jeta në Kosovë”

Emisioni “Jeta në Kosovë” është bashkëprodhim i RTK-së dhe Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN). Natyra e këtij emisioni më shumë i përket një omnibusi me një bazë prej një apo dy debateve në studio dhe disa storje hulumtuese që transmetohen në mes të debateve, por edhe para e pas tyre. Këto storje nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me debatin.

Gjatë monitorimit të pjesës së debateve në kuadër të këtij emisioni, KIPRED ka vërejtur një përzgjedhje të mirë të temave që debatohen, të cilat ose janë tema aktuale ose tema që e preokupojnë publikun kosovar.

Mysafirët kryesisht kanë qenë të balancuar përfshirë ata nga pozita, opozita, shoqëria civile, dhe grupe tjera të interesit. Reprerentimi i faktorëve kyç, të temave të trajtuara në debat ka qenë në nivel të duhur. Përjashtim bën emisioni me temën “Zbatimi i ligjit komunal” ku ishin të ftuar përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), shoqëria civile si dhe ekspertë të pushtetit lokal, e ku u ngritën shumë kritika për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, përkundër faktit që në debat nuk ishin të pranishëm përfaqësuesit e këtij institucioni.<sup>29</sup>

Një tipar tjetër negativ në këtë emision ka të bëjë me orarin e transmetimeve, i cili në shumë raste nuk ka qenë i saktë sipas skemës programore të RTK-së. Vonesat në transmetim nuk paralajmërohen, gjë që mund të shkaktojë neveri të audiencia televizive.

Pos debatit në studio, “Jeta në Kosovë” mbetet i vetmi emision të cilin e kemi monitoruar e në të cilin transmetohen storje që kanë karakter hulumtues dhe zakonisht janë

<sup>29</sup> “Jeta në Kosovë” edicioni i datës 15 prill 2010.

ekskluzive. Megjithatë, do të ishte mirë që storje të këtilla të jenë të shtrira më mirë përgjatë skemës programore të RTK-së dhe jo të përqendruara në një termin të vetëm, në një ditë të vetme.

### 5.3. “Protagonisti”

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar gjithsej tri edicione të këtij emisioni me karakter intervistues. Për secilin emision janë ftuar për intervistë zyrtarë të ndryshëm duke përfshirë ata nga qeveria dhe opozita.

Në mes të bisedës me mysafirë transmetohen edhe dy intervista të zhvilluar më parë me individ të cilët kanë pikëpamje të ndryshme për çështjet të cilat prezantohen nga i ftuari në studio. Në monitorim kemi vërejtur një përzgjedhje të mirë të mysafirëve për të komentuar temat, të cilat po ashtu kanë qenë të zgjedhura mirë. Megjithatë, duhet të cekim se ky format nuk e përfshinë diskutimin e drejtpërdrejt të personit në studio dhe personave jashtë studios të cilët shprehin mendimet e tyre përmes videos së xhiruar më herët. Kësisoj, personave të intervistuar për inserte të tilla nuk u është dhënë mundësia që në mënyrë të denjë t’i sfidojnë të ftuarit, që zakonisht kanë qenë nga sektori qeveritar.

### 5.4. Emisionet “Speciale”

Ani pse në skemën e rregullt të programit të RTK-së nuk figuron si emision i veçantë, “Speciale” është titulli me të cilin RTK-ja i transmeton intervistat apo debatet e veçanta, kryesisht me tema aktuale. Gjatë monitorimit janë transmetuar gjithsej shtatë (7) këso emisione. Prej tyre, tri emisione, të cilat po ashtu janë ritransmetuar, kanë qenë intervista me zyrtarë të lartë të qeverisë, kurse dy tjera me presidencën. Në fokus të monitorimit kanë qenë dy intervista, njëra me Kryeministrin e Kosovës dhe tjetra me Ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.

Intervistës ekskluzive me Kryeministrin e Kosovës, RTK-ja i ka dhënë një rëndësi tejet të veçantë.<sup>30</sup> Kjo intervistë, përpos që është transmetuar në orar të mirë, është paralajmëruar edhe në edicionin qendror të lajmeve. Sikurse asnjë intervistë tjetër me zyrtarë të qeverisë në edicionet speciale, as kjo intervistë nuk ka qenë sfiduese. Kryeministrit i është lejuar kohë e pakufizuar për përgjigje, nuk është insistuar që ai të përgjigjet në pyetjet e parashtruara dhe intervistuesi nuk e ka pasur nën kontroll ecurinë e intervistës si do duhej ta kishte. Në fakt, ecurinë e intervistës e ka kontrolluar tërësisht i intervistuari, i cili në raste të caktuara edhe e ka ndërprerë intervistuesin gjatë parashtrimit të pyetjeve.

I njëjti fenomen i mos kontrollit të intervistës nga intervistuesi është vënë re edhe gjatë intervistës tjetër ekskluzive, me Ministrin e Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit, Fatmir Limaj.<sup>31</sup> Gjatë kësaj interviste janë shkelur një sërë nenesh të kodit të etikës dhe standardeve profesionale nga ana e gazetarit intervistues. Gazetari, gjatë kësaj interviste

<sup>30</sup> Intervistë në kuadër të emisionit “Speciale” transmetuar me 5 maj 2010

<sup>31</sup> Intervistë në kuadër të emisionit “Speciale” transmetuar me 13 maj 2010

përpos që ka bërë konstatime të pabazuara në ndonjë burim, ka shkuar aq larg sa që ka dhënë edhe opinionin e vet, duke thyer kështu normat ndërkombëtare të gazetarisë si dhe kodin e RTK-së.<sup>32</sup> Rastet e tilla do duhej pikë së pari të evitoheshin, e nëse ndodhin të sanksionohen nga kolegji i redaktorial i RTK-së, meqë përbëjnë shkelje serioze të standardeve profesionale dhe kodit të etikës.

## **6. SQARIME**

Ky raport është bazuar në monitorim të drejtpërdrejtë të programit informativ të kanalit të vetëm televiziv të Radiotelevizionit të Kosovës. Monitorimi dhe përpilimi i këtij raporti janë kryer në mënyrë të pavarur dhe gjatë përpilimit nuk janë konsultuar as intervistuar përfaqësuesit e RTK-së, bordit të RTK-së apo ndonjë pale tjetër.

Raporti është prodhim i një pilot-projekti tremujor, të cilin KIPRED mëton ta shndërroj në një projekt më afatgjatë, në mënyrë që të avancoj edhe më tutje nivelin e profesionalizmit në RTK.

Ky raport është një raport për diskutim, i cili do të prezantohet në një tryezë të rrumbullakët, para një spektri të gjerë të institucioneve adekuate, përfshirë edhe menaxhmentin dhe bordin e RTK-së, me 5 tetor 2010. Nga kjo tryezë KIPRED do të draftojë rekomandimet konkrete që dalin nga gjetjet e këtij raporti. Raporti i plotësuar me rekomandime dhe një përmbledhje ekzekutive do të publikohet nga instituti KIPRED.

## **6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Rëndësia e transmetuesit publik Kosovar është qenësore për zhvillimin e një demokracie të shëndetshme dhe një debati publik të informuar mirë, pjesërisht sepse ky transmetues financohet nga taksapaguesit. Me këtë në mendje, KIPRED ka monitoruar programin informativ të RTK-së, duke i dhënë vëmendje të veçantë kualitetit dhe larmisë së lajmeve të RTK. Gjetjet nga ky monitorim, të cilat janë përfshirë në këtë raport, kanë çuar në një numër rekomandimesh qenësore për përmirësimin e programit informativ të RTK.

Për të përmirësuar cilësinë e punës së tyre, ne i rekomandojmë RTK që të implementojë të mëposhtmet.

1. RTK duhet të sigurojë që storjet e tyre të bazohen në çështje apo probleme të cilat në vete kanë një rëndësi më të madhe sesa thjesht përçimin e një ndodhie. Për shembull, storjet protokollare të cilat merren me takime por që në vete nuk trajtojnë ndonjë çështje duhet të mënjanohen.

2. Duhet të rritet konsiderueshëm numri i storjeve të mirëfillta hulumtuese. Stafi redaktorial i RTK duhet të përpilojë një strategji dhe listë të çështjeve të cilat duhen hulumtuar në thellësi. Për këtë arsye, RTK duhet ti japë më shumë hapësirë,

---

<sup>32</sup> Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës”, neni 5.7, RTK, Janar 2005

kohë dhe resurse gazetarëve të cilët bëjnë hulumtime të tilla qoftë në bazë të politikës redaktoriale apo ideve të veta.

3. RTK menjëherë duhet të eliminojë komplet storjet të cilat përmbajnë akuza të njëanshme pa përfaqësim të palës së akuzuar. Kjo duhet të bëhet edhe nëse RTK planifikon që gjatë një edicioni tjetër të japë mendimin e palës së akuzuar.

4. Tre (3) lajmet e para në një edicion informativ duhet të përmbajnë në vete çështje të rëndësishme për shoqërinë dhe jo evenimente protokollare qeveritare apo lloje të tjera të storjeve të cilat nuk pajtohen me rekomandimin numër 1 të këtij raporti.

5. Gjithashtu, RTK duhet të sigurojë që këtë përfaqësim më të denjë të sektorit jo-qeveritar në tre lajmet e para. Bizneset, rinia, çështjet gjinore, shoqëria civile si dhe storjet hulumtuese janë vetëm disa nga temat të cilat duhet të jenë në pjesën më të rëndësishme të një edicioni informativ.

Për të përforcuar këto pika, dhe si shtesë qenësore për RTK, KIPRED gjithashtu rekomandon që:

6. RTK të rishikojë dhe rishkruajë në mënyrë drastike kodin e tyre etik dhe profesional. Kodi i ri duhet të sajohet nga një panel profesionistësh medial të cilët do të merren me specifikimin e mënyrave se si mbulohen një mëri çështjesh me të cilat mediat moderne ballafaqohen dita ditës.

7. RTK të trajtojë stafin e gazetarëve dhe redaktorëve të tyre në mënyrë të tërthortë në njohjen, përdorimin dhe ndjekjen e kodit të tyre profesional dhe etik. Që të arrijë këtë qëllim, RTK gjithashtu duhet të zhvillojë mekanizma konkrete për zbatimin e këtij kodi, sidomos nga stafi redaktorial ndërkohë që ata kontrollojnë storjet dhe materialin e emisioneve të tjera. Gjithashtu, duhet të zhvillohet një mekanizëm i qartë dhe i rreptë i dënimit në rast të shkeljes së këtij kodi.

8. Ka nevojë esenciale për ndarje të vendosur në mes të stafit redaktorial dhe udhëheqës. Kjo ndarje do të sigurojë që të mos ketë presion institucional apo financiar ndaj redaksisë dhe gazetarëve. Heqja e këtij presioni, të vërtetë apo të perceptuar, do të shpie në zhvillimin e politikave të pavarura dhe kualitative redaktoriale.

9. Të përmirësohet menaxhimi i resurseve njerëzore. RTK duhet të punojë në mënyrë të konsiderueshme që të profesionalizojë stafin e vet. Trajnime të vazhdueshme për stafin, sidomos gazetarëve të rinj, si dhe një monitorim i gazetarëve nga redaktorët janë qenësor për rritjen e profesionalitetit dhe kualitetit të lajmeve. Departamenti i resurseve njerëzore duhet të ketë një kujdes të jashtëzakonshëm në procedurat e punësimit dhe monitorimit të stafit. Gjithashtu, menaxhimi i gazetarëve duhet të jetë më adekuat, duke siguruar që gazetarët me më shumë përvojë të merren më çështje dhe hulumtime me të rëndësishme.

10. RTK duhet të sigurojë një monitorim të vazhdueshëm kualitativ të lajmeve të tyre, monitorim ky që mundësisht të jetë i pavarur. Në afat të gjatë, një punë e tillë mund të shpie deri te profesionalizimi i kritikëve të mirëfilltë të mediave, që do të lehtësonte punën e bërë nga ky raport.

KIPRED rekomandon zëshëm monitorimin e vazhdueshëm të RTK si transmetues publik nga faktorë të pavarur qoftë ndërkombëtarë apo vendorë në mënyrë që të sigurojmë që ky medium të ketë kualitetin e kërkuar nga një medium profesional modern.